

VENDIM
Nr.83, datë 27.11.2006

**PËR LICENCIMIN E “ENERGO SAS” SHPK PËR NDËRTIMIN, INSTALIMIN DHE
PRODHIMIN E ENERGJISË NGA HEC SASAJ**

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1 germa a, dhe 16 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, ndryshuar me ligjin nr.9512, datë 10.4.2006 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003”, “Për sektorin e energjisë elektrike”, rregullores për procedurat e licencimit, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionierëve të ERE-s, nr.27, datë 30.5.2004, të ndryshuar, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.51, datë 15.9.2006 “Për fillimin e procedurave të shqyrtimit”, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 27.11.2006, pasi shqyrtoi aprovimin nga shoqëria “Energo Sas” sh.p.k. për licencimin për aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Sasaj,

KONSTATON SE:

Nga tërësia e kërkesave të parashikuara në aktet e mësipërme “Energo Sas” sh.p.k. nuk ka plotësuar kushtin e marrjes së lejes së përdorimit të ujit dhe se nga dokumentacioni i dërguar në ERE rezulton se shoqëria është në proces të miratimit të dhënies së lejes së ujit nga Agjencia e Ujit Vlorë.

Përsa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë “Energo Sas” sh.p.k. për aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centralit elektrik dhe prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Sasaj me afat 30 vjet.

2. Brenda afatit të përfundimit të punimeve të ndërtimit të HEC Sasaj, vënies në punë të tij dhe lidhjes me sistemin elektroenergjetik, “Energo Sas” sh.p.k. të pajiset dhe të paraqesë në ERE lejen e përdorimit të ujit.

3. Afati i fillimit të shfrytëzimit të HEC-it është data 1.3.2008.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta